




ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE



## KOMISIONI PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Nr. 167

Prishtinë, 19.05.2026

### V E N D I M

#### PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR KANDIDIM PËR KRYETAR TË ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS

Në bazë të nenit 15, 16 dhe 17 të Ligjit Nr. 2004/7 për Odën Ekonomike të Kosovës, si dhe nenit 21.3, 23.1.5, 23.1.7, 23.1.8, 26.1, 27.3 dhe 29 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur më 13.05.2026, merr këtë:

### V E N D I M

#### I.

Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve njofton të gjithë anëtarët e certifikuar të Kuvendit të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), se kanë të drejtë të kandidojnë për pozitën e Kryetarit të OEK-ut.

Kandidaturat dorëzohen pranë Komisionit për Zbatimin e Zgjedhjeve dhe duhet të përmbajnë dokumentacionin e kërkuar, duke respektuar kriteret dhe kushtet në vijim:

- Kandidati për Kryetar të OEK-ut duhet të jetë anëtar i Kuvendit të konstituar të OEK-ut;
- Kryetari i OEK-ut zgjidhet me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat;
- Kandidat nuk mund të jetë personi i cili ka ushtruar dy mandate të plota si Kryetar i OEK-ut;
- Kandidati duhet të ketë shtetësinë e Republikës së Kosovës;
- Kandidati duhet të ketë vendbanim të përhershëm në Republikën e Kosovës;
- Kandidati duhet të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune;
- Kandidati duhet të ketë njohje të gjuhëve të huaja;



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

## V.

Njoftimi për shpalljen e thirrjes për kandidim u dërgohet të gjithë anëtarëve të Kuvendit të OEK-ut në adresat elektronike të deklaruara në autorizimin për përfaqësim. Njoftimi publikohet edhe në faqen zyrtare të OEK-ut.

Afati për aplikim është pesë (5) ditë nga data e publikimit të këtij vendimi, fillon më 19.05.2026 dhe përfundon më 24.05.2026.

Aplikimi për kandidim duhet të bëhet përmes postës elektronike në adresën: [komisioni@oek-kcc.org](mailto:komisioni@oek-kcc.org), brenda afatit të përcaktuar.

Kandidatët të cilët nuk kanë mundur të bashkëngjisin dokumentacionin e plotë në formë elektronike, mund ta dorëzojnë dokumentacionin fizikisht pranë administratës/arkivës së OEK-ut deri më 25.05.2026 në ora 16:00, në zarf të mbyllur.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të aplikimit, si dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit të përcaktuar, nuk do të merren në shqyrtim.

## VI.

Pas skadimit të afatit për aplikim, Komisioni nuk do të marrë në shqyrtim kandidaturat e vonuara ose kandidaturat me dokumentacion jo të plotë, dhe të njëjtat nuk do t'i rekomandohen Kuvendit të OEK-ut.

## VII.

Vendimi u dërgohet:

- anëtarëve të Komisionit për Zbatimin e Zgjedhjeve;
- Arkivit të OEK-ut.

## VIII.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve dhe është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët e Kuvendit të OEK-ut dhe administratën e OEK-ut.



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

- Kandidati nuk mund të jetë person i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale apo për kriminalitet ekonomik;
- Përmbushja e kriterit nga paragrafi paraparak dëshmohet me Certifikatë mbi dënimet penale, të lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale i Republikës së Kosovës përmes platformës eKosova;
- Kandidati duhet të jetë i diplomuar në nivel universitar dhe duhet ta dëshmojë atë;
- Kandidati duhet të dorëzojë biografinë profesionale (CV) dhe dëshmi për përvojën e punës.

## II.

Kandidati për Kryetar të OEK-ut duhet të jetë përfaqësues i autorizuar i një subjekti juridik anëtar të Kuvendit të OEK-ut dhe të ketë marrëdhënie të rregulluar pronësie ose marrëdhënie pune aktive me atë subjekt para datës 31.12.2025, në përputhje me kriteret e vlefshmërisë së të drejtave zgjedhore.

Autorizimi për përfaqësim dhe kandidim duhet të jetë i lëshuar nga subjekti juridik përkatës dhe i verifikuar nga Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve, në pajtim me Ligjin dhe Statutin e OEK-ut.

## III.

Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve shqyrton dhe verifikon të gjitha kandidaturat e paraqitura, dokumentacionin përcjellës dhe përmbushjen e kushteve ligjore dhe statutare.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioni përpilon listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar dhe ia procedon atë Kuvendit të OEK-ut për shqyrtim dhe votim në seancën konstituive.

## IV.

Secili kandidat për Kryetar të OEK-ut, së bashku me kandidaturën, duhet të dorëzojë edhe propozimin paraparak për përbërjen e Këshillit Drejtues të OEK-ut, në përbërje prej dymbëdhjetë (12) anëtarësh, si vijon:

- shtatë (7) anëtarë nga Shoqatat sektoriale;
- një (1) anëtar nga Shoqatat me anëtarësi kolektive;
- katër (4) anëtarë nga Njësitë Rajonale.



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER  
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve është përgjegjës për zbatimin e plotë të këtij vendimi, duke siguruar transparencë, trajtim të barabartë të kandidatëve dhe respektim të afateve të përcaktuara me këtë vendim.

**KOMISIONI PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE**

Samir Lleshi

Erleta Halimi

Valdet Gjinovci

Ramadan Kelendi

Bujar Kelmendi

